

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 620

PËRDORIMI I PUNËS SË EKSPERTIT TË AUDITUESIT

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1-2
Përgjegjësia e Audituesit për Opinionin e Auditimit	3
Hyrja në fuqi	4
Objektivat	5
Përkufizimet	6
Kërkesat	
Përcaktimi i Nevojës për Ekspertin e Audituesit	7
Natyra, Kohëzgjatja dhe Shtrirja e Procedurave të Auditimit	8
Kompetenca, Aftësitë dhe Objektiviteti i Ekspertit të Audituesit	9
Njohja e Fushës së Ekspertizës të Ekspertit të Audituesit	10
Marrëveshja me Ekspertin e Audituesit	11
Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Punës së Ekspertit të Audituesit	12-13
Referimi i Ekspertit të Audituesit në Raportin e Auditimit	14-15
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Përkufizimi i Ekspertit të Audituesit	A1-A3
Përcaktimi i Nevojës për Ekspertin e Audituesit	A4-A9
Natyra, Kohëzgjatja dhe Shtrirja e Procedurave të Auditimit	A10-A13
Kompetenca, Aftësitë dhe Objektiviteti i Ekspertit të Audituesit	A14-A20
Njohja e Fushës së Ekspertizës të Ekspertit të Audituesit	A21-A22
Marrëveshja me Ekspertin e Audituesit	A23- A31
Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Punës së Ekspertit të Audituesit	A32- A40
Referimi i Ekspertit të Audituesit në Raportin e Auditimit	A41- A42
Shtojcë: Konsiderata në lidhje me Marrëveshjen ndërmjet Audituesit dhe Ekspertit të Audituesit të Jashtëm	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 620 “Përdorimi i Punës së Ekspertit të Audituesit” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësinë e audituesit në lidhje me punën e një individi ose organizate që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti ose auditimi, në rastin kur kjo punë është përdorur nga audituesi për ta ndihmuar atë për të siguruar evidencën e mjaftueshme dhe të nevojshme të auditimit.
2. Ky SNA nuk përfshin:
 - (a) Situatat në të cilat grupi i angazhimit përfshin një pjesëtar, ose konsultohet me një individ ose organizatë, që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti ose auditimi, raste të cilat trajtohen nga SNA 220;¹ ose
 - (b) Përdorimi nga ana e audituesit i punës së një individi ose organizate, që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti ose auditimi, punë e të cilit në atë fushë është përdorur nga entiteti për të ndihmuar entitetin në përgatitjen e pasqyrave financiare (një ekspert i drejtimit), rast i cili trajtohet nga SNA 500.²

Përgjegjësia e Audituesit për Opinionin e Auditimit

3. Audituesi ka përgjegjësinë e vetme për shprehjen e opinionit të auditimit, dhe kjo përgjegjësi nuk reduktohet nga përdorimi nga ana e audituesit e punës së ekspertit të audituesit. Pavarësisht nga kjo, nëse audituesi i cili përdor punën e ekspertit, në përputhje me këtë SNA, arrin në përfundimin që puna e ekspertit është e përshtatshme për qëllimin e audituesit, audituesi mund të pranojë gjetjet ose konkluzionet e ekspertit në fushën e ekspertit si evidencë të përshtatshme auditimi.

Hyrja në fuqi

4. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivat

5. Objektivat e audituesit janë:
 - (a) Të përcaktojë nëse duhet përdorur puna e ekspertit të audituesit; dhe
 - (b) Nëse përdoret puna e ekspertit, të përcaktohet nëse kjo punë është e përshtatshme për qëllimet e audituesit.

¹ SNA 220, *Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafët A11, A21–A23.

² SNA 500, *Evidenca e Auditimit*, paragrafët A35–A49.

Përkufizimet

6. Për qëllime të SNA-ve, termat e mëposhtëm kanë kuptimet që ju janë dhënë në vijim:
- (a) Eksperti i audituesit – Një individ ose organizate që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti ose auditimi, puna e të cilit në atë fushë është përdorur nga audituesi për ta ndihmuar atë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit. Një ekspert i audituesit mund të jetë ose një ekspert i brendshëm i audituesit (i cili është një ortak³ ose personel, përfshirë personelin e përkohshëm të firmës së auditimit ose të një firme rrjet) apo edhe një ekspert i audituesit i jashtëm. (Ref: Para. A1–A3)
 - (b) Ekspertiza – Aftësitë, njohuritë dhe eskerienca në një fushë të veçantë.
 - (c) Ekspert i drejtitimit – Një individ ose organizatë që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti ose auditimi, puna e të cilës në atë fushë është përdorur nga entiteti për ta ndihmuar këtë të fundit në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Kërkesat

Përcaktimi i Nevojës për Ekspertin e Audituesit

7. Nëse një ekspertizë në një fushë të ndryshme nga ajo e kontabilitetit dhe auditimit është e nevojshme për të siguruar një evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, audituesi duhet të përcaktojë nëse duhet të përdorë punën e një eksperti të audituesit. (Ref: Para. A4–A9)

Natyra, Kohëzgjatja dhe Shtrirja e Procedurave të Auditimit

8. Natyra, kohëzgjatja dhe shtrirja e procedurave të audituesit në lidhje me kërkesat në paragrafët 9–13 të këtij SNA-je do të ndryshojë në varësi të rrethanave. Në përcaktimin e natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së këtyre procedurave, audituesi duhet të marrë parasysh çështje që përfshijnë: (Ref: Para. A10)
- (a) Natyrën e çështjes me të cilën lidhet puna e ekspertit;
 - (b) Rrezikun e anomalisë materiale në çështjen me të cilën lidhet puna e ekspertit;
 - (c) Rëndësinë e punës së ekspertit në kontekstin e auditimit;

³ “Ortak” dhe “firmë” duhet të lexohen duke ju referuar ekuivalentëve të tyre për sektorin publik, aty ku është e përshtatshme.

- (d) Njohuritë e audituesit dhe eksperiencia e tij me punën e bërë më parë nga eksperti; dhe
- (e) Nëse eksperti është subjekt i politikave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë të firmës së auditimit. (Ref: Para. A11–A13)

Kompetenca, Aftësitë dhe Objektiviteti i Ekspertit të Audituesit

9. Audituesi duhet të vlerësojë nëse eksperti ka kompetencën, aftësitë dhe objektivitetin e nevojshëm për qëllimet e audituesit. Në rastin e një eksperti të audituesit të jashtëm, vlerësimi i objektivitetit do të përfshijë pyetje që lidhen me interesin dhe marrëdhëniet që mund të krijojnë rrezik për objektivitetin e ekspertit. (Ref: Para. A14–A20)

Njohja e Fushës së Ekspertizës të Ekspertit të Audituesit

10. Audituesi duhet të njohë mjaftueshëm fushën e ekspertizës së ekspertit, fakt që do ta ndihmojë audituesin të: (Ref: Para. A21–A22)
- (a) Përcaktojë natyrën, objektin dhe objektivat e punës së ekspertit për qëllimet e audituesit; dhe
 - (b) Të vlerësojë përshtatshmërinë e punës së ekspertit për qëllimet e audituesit.

Marrëveshja me Ekspertin e Audituesit

11. Audituesi duhet të bjerë dakort me ekspertin e audituesit, ku është e përshtatshme në mënyrë të shkruar, për çështjet e mëposhtme: (Ref: Para. A23–A26)
- (a) Natyrën, objektin dhe objektivat e punës së ekspertit; (Ref: Para. A27)
 - (b) Rolin dhe përgjegjësitë e audituesit dhe të ekspertit; (Ref: Para. A28–A29)
 - (c) Natyrën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e komunikimit ndërmjet audituesit dhe ekspertit, duke përfshirë formën e çdo raporti që do të sigurohet nga eksperti; dhe (Ref: Para. A30)
 - (d) Nevojën që eksperti i audituesit të tregojë kujdes lidhur me kërkesat e konfidencialitetit. (Ref: Para. A31)

Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Punës së Ekspertit të Audituesit

12. Audituesi duhet të vlerësojë përshtatshmërinë e punës së ekspertit për qëllimet e audituesit, duke përfshirë: (Ref: Para. A32)

PËRDORIMI I PUNËS SË EKSPERTIT TË AUDITUESIT

- (a) Rëndësinë dhe arsyeshmërinë e gjetjeve dhe konkluzioneve të ekspertit, dhe koherencën e tyre me procedurat e tjera të auditimit; (Ref: Para. A33–A34)
 - (b) Nëse puna e ekspertit përfshin përdorimin e metodave dhe supozimeve të rëndësishme, rëndësinë dhe arsyeshmërinë e këtyre supozimeve dhe metodave për rrethanat; dhe (Ref: Para. A35–A37)
 - (c) Nëse puna e ekspertit përfshin përdorimin e një burimi të dhënash që është i rëndësishëm për punën e ekspertit, rëndësinë, plotësinë, dhe saktësinë e këtij burimi të dhënash. (Ref: Para. A38–A39)
13. Nëse audituesi vendos që puna e ekspertit nuk është e përshtatshme për qëllimet e audituesit, audituesi duhet: (Ref: Para. A40)
- (a) Të bjerë dakort me ekspertin për natyrën dhe shtrirjen e punës shtesë që duhet të kryhet nga eksperti; ose
 - (b) Të kryejë procedura auditimi shtesë të përshtatshme për rrethanat.

Referimi i Ekspertit të Audituesit në Raportin e Audituesit

14. Audituesi nuk duhet ti referohet punës së ekspertit në raportin e audituesit që përmban një opinion të pamodifikuar, përveç rasteve kur një gjë e tillë kërkohet me ligj apo me rregullore. Nëse referimi kërkohet me ligj apo me rregullore, audituesi duhet të tregojë në raportin e auditimit se referimi nuk e redukton përgjegjësinë e audituesit për opinionin e auditimit. (Ref: Para. A41)
15. Nëse audituesi bën referim për punën e ekspertit të audituesit në raportin e auditimit pasi një referim i tillë është i rëndësishëm për të kuptuar modifikimin e opinionit të audituesit, audituesi duhet të tregojë në raportin e auditimit që një referim i tillë nuk e redukton përgjegjësinë e audituesit për opinionin e auditimit. (Ref: Para. A42)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Përkufizimi i Ekspertit të Audituesit (Ref: Para. 6(a))

- A1. Ekspertiza në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti dhe auditimi mund të përfshijë ekspertizën në lidhje me çështje të tilla si:
- Vlerësimi i instrumentave financiarë kompleks, tokës dhe ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve, stolive të çmuara, punimeve artistike, antikuareve, aktiveve jomateriale, aktiveve të blera dhe detyrimeve të supozuara në kombinimin e bizneseve dhe aktiveve të cilat mund të kenë pësuar rënie vlere.

- Llogaritja aktuariale e detyrimeve që lidhen me kontratat e sigurimeve ose planet e përfitimit të punonjëseve.
 - Vlerësimi i rezervave të naftës dhe gazit.
 - Vlerësimi i detyrimeve mjedisore, dhe kostove të pastrimit.
 - Interpretimi i kontratave, ligjeve dhe rregulloreve.
 - Analiza të çështjeve komplekse dhe jo të zakonshme të taksave.
- A2. Në shumë raste, dallimi ndërmjet ekspertizës në kontabilitet ose auditim, dhe ekspertizës në një fushë tjetër, do të jetë shumë i qartë, madje edhe në rastet kur kjo përfshin një fushë të specializuar të kontabilitetit ose auditimit. Për shembull, një individ me ekspertizë në përdorimin e metodave të kontabilitetit për tatimin e shtyrë shpesh mund të dallohet lehtë nga një ekspert në ligjet tatimore. I pari, nuk është një ekspert për qëllimin e këtij SNA-je pasi kjo ka të bëjë me ekspertizë në kontabilitet; i dyti është një ekspert për qëllimin e këtij SNA-je pasi kjo ka të bëjë me ekspertizë ligjore. Dallime të tilla mund të bëhen gjithashtu edhe në fusha të tjera, për shembull, ndërmjet ekspertizës në metodat e kontabilitetit për instrumentat financiarë, dhe ekspertizës në modelimet komplekse për qëllime të vlerësimit të instrumentave financiarë. Gjithsesi, në disa raste, veçanërisht në ato që përfshijnë fusha të zhvilluara të ekspertizës kontabile dhe të auditimit, dallimi ndërmjet fushave të specializuara të kontabilitetit dhe auditimit, dhe ekspertizës në një fushë tjetër, do të jetë një çështje e gjykimit profesional. Rregullat profesionale dhe standardet e zbatueshme që lidhen me edukimin dhe kërkesat e kompetencës për kontabilistët dhe audituesit mund të ndihmojnë audituesin të ushtrojë këtë gjykim.⁴
- A3. Është e nevojshme të përdorësh gjykimin kur merret në konsideratë se si kërkesat e këtij SNA-je ndikohen nga fakti që eksperti i audituesit mund të jetë ose një individ ose një organizatë. Për shembull, kur vlerësohen kompetenca, aftësitë dhe objektiviteti i ekspertit, mund të ndodhë që eksperti të jetë një organizatë me të cilën audituesi ka punuar më parë, por audituesi nuk ka eksperiencë me ekspertin, individin e përcaktuar nga organizata për angazhimin specifik; ose mund të jetë e kundërta, që audituesi mund të jetë familjar me punën e ekspertit individual por jo me organizatën me të cilën individit është bashkuar. Në secilin rast, si atributet personale të individit ashtu dhe atributet drejtuese të organizatës (të tilla si sistemet e kontrollit të cilësisë që organizata zbaton) mund të jenë të rëndësishme në vlerësimin e audituesit.

⁴ Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Edukimit 8, *Kërkesat e Kompetencës për Profesionistët e Auditimit* mund të ndihmojë në këtë aspekt.

Përcaktimi i Nevojës për Ekspertin e Audituesit (Ref: Para. 7)

A4. Eksperti i audituesit mund të nevojitet për të ndihmuar audituesin në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

- Për të njohur entitetin dhe mjedisin e tij, përfshirë kontrollin e tij të brëndshëm.
- Identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale.
- Përcaktimin dhe zbatimin e përgjigjeve të përgjithshme për rrezikun e vlerësuar në nivelin e pasqyrave financiare.
- Hartimin dhe zbatimin e procedurave shtesë për t'ju përgjigjur rrezikut të vlerësuar në nivel pohimi, përfshirë testet e kontrollit të brëndshëm ose procedurat thelbësore.
- Vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencës së auditimit të siguar për formimin e opinionit mbi pasqyrat financiare.

A5. Rreziku i anomalisë materiale mund të rritet, kur nga drejtimi nevojitet ekspertizë në një fushë të ndryshme nga ajo e kontabilitetit, për shembull për përgatitjen e pasqyrave financiare, sepse ky fakt mund të tregojë për ekzistencën e rrethanave komplekse, ose sepse drejtimi mund të mos ketë njohuri në fushën e ekspertizës. Nëse në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtimi nuk zotëron ekspertizën e nevojshme, eksperti i drejtimit mund të ndihmojë për adresimin e rreziqeve. Kontrollat e përshtatshme, duke përfshirë kontrollat që lidhen me punën e ekspertit të drejtimit, nëse ka, mundet gjithashtu të reduktojnë rrezikun e anomalisë materiale.

A6. Nëse përgatitja e pasqyrave financiare përfshin përdorimin e ekspertizës në një fushë të ndryshme nga ajo e kontabilitetit, audituesi, i cili është i aftë në kontabilitet dhe auditim, mund të mos zotërojë ekspertizën e nevojshme për të audituar këto pasqyra financiare. Ortaku i angazhimit duhet të jetë i bindur se grupi i angazhimit, dhe eksperti i audituesit që nuk është pjesë e grupit të auditimit, së bashku, kanë kompetencën e nevojshme dhe aftësitë e duhura për të kryer angazhimin e auditimit⁵. Për më tepër, audituesi është i detyruar të përcaktojë natyrën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e burimeve të nevojshme për të kryer angazhimin⁶. Vendosmëria e audituesit nëse duhet përdorur apo jo puna e ekspertit, dhe në rast se po deri në çfarë mase, ndihmon audituesin në përmbushjen e këtyre kërkesave. Ndërsa auditimi vazhdon, ose në rast se rrethanat ndryshojnë, audituesi mund ta ketë të nevojshme që të rishikojë vendimet e mëparshme rreth përdorimit të punës së ekspertit.

A7. Një auditues i cili nuk është ekspert në një fushë të caktuar të ndryshme nga ajo e kontabilitetit dhe auditimit mundet gjithsesi të jetë në gjendje të sigurojë një kuptim

⁵ SNA 220, paragrafi 14.

⁶ SNA 300, *Planifikimi i Auditimit të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 8(e).

të mjaftueshëm të kësaj fushe për të kryer auditimin pa një ekspert. Kjo njohuri mund të sigurohet nëpërmjet, për shembull:

- Eksperiencës në auditimin e entiteteve të cilat kërkojnë një ekspertizë të tillë në përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Zhvillimet edukative ose profesionale në fushën e caktuar. Kjo mund të përfshijë kurse formale, ose diskutime me individë që zotërojnë ekspertizë në fushën në fjalë me qëllimin e rritjes së kapacitetit të vetë audituesit për tu marrë me çështje në këtë fushë. Diskutime të tilla ndryshojnë nga konsultimet me ekspertin e audituesit lidhur me një tërësi rrethanash specifike të hasura në një angazhim, ku ekspertit i janë dhënë të gjitha faktet e duhura që do ti krijojnë mundësinë atij të japë këshillim të informuar mbi çështjen e caktuar⁷.
- Diskutimi me auditues të cilët kanë kryer angazhime të ngjashme.

A8. Megjithatë në raste të tjera, audituesi mund të vendosë që është e nevojshme, ose mund të zgjedhë, të përdorë një ekspert për ta ndihmuar atë të sigurojë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Konsideratat, kur vendoset nëse do të përdoret një ekspert, mund të përfshijnë:

- Nëse drejtimi ka përdorur një ekspert të drejtimit në përgatitjen e pasqyrave financiare (shih paragrafin A9).
- Natyra dhe rëndësia e çështjes, përfshirë kompleksitetin e saj.
- Rreziqet e anomalisë materiale në çështje.
- Natyra e pritshme e procedurave për t'ju përgjigjur rreziqeve të identifikuara, përfshirë: njohuritë e audituesit dhe eksperiencën me punën e ekspertit në lidhje me çështje të tilla; dhe disponueshmërinë e burimeve alternative të evidencës së auditimit.

A9. Kur drejtimi ka përdorur një ekspert të drejtimit në përgatitjen e pasqyrave financiare, vendimi i audituesit nëse duhet të përfshijë një ekspert mund të ndikohet gjithashtu edhe nga faktorë të tillë si:

- Natyra, objekti dhe objektivat e punës së ekspertit të drejtimit.
- Nëse eksperti i drejtimit është i punësuar nga entiteti, ose është një palë e angazhuar nga entiteti për t'i siguruar shërbime të caktuara.
- Shtrirja deri ku drejtimi mund të ushtrojë kontroll ose ndikim mbi punën e ekspertit të drejtimit.

⁷ SNA 220, paragrafi A22.

- Kompetenca dhe aftësitë e ekspertit të drejtimit.
- Nëse eksperti i drejtimit është subjekt i standardeve teknike të performancës ose kërkesave të tjera profesionale ose të sektorit të industrisë.
- Kontrollat brenda entitetit mbi punën e ekspertit të drejtimit.

SNA 500⁸ përfshin kërkesa dhe udhëzime në lidhje me efektin e kompetencës, aftësitë dhe objektivitetin e ekspertit të drejtimit mbi besueshmërinë e evidencës së auditimit.

Natyrë, Kohëzgjatja dhe Shtrirja e Procedurave të Auditimit (Ref: Para. 8)

A10. Natyrë, kohëzgjatja dhe shtrirja e procedurave në lidhje me kërkesat në paragrafët 9–13 të këtij SNA do të variojë në varësi të rrethanave. Për shembull, faktorët e mëposhtëm mund të sugjerojnë nevojën për procedura të ndryshme ose më të zgjata seç do të ishte në rast të kundërt:

- Puna e ekspertit të auditimit lidhet me një çështje të rëndësishme që përfshin gjykim subjektiv dhe kompleks.
- Audituesi nuk e ka përdorur më parë punën e ekspertit të audituesit, dhe nuk ka njohuri të mëparshme të kompetencës, aftësive dhe objektivitetit të këtij eksperti.
- Eksperti i audituesit po kryen procedura që janë pjesë e pandarë e auditimit, më tepër se të konsultohet për të dhënë këshillim për një çështje të caktuar.
- Eksperti është një ekspert i jashtëm i audituesit dhe si rrjedhojë nuk është subjekt i procedurave dhe politikave të kontrollit të cilësisë së firmës.

Procedurat dhe Politikat e Kontrollit të Cilësisë të Firmës së Audituesit (Ref: Para. 8(e))

A11. Eksperti i brendshëm i audituesit mund të jetë një ortak ose personel i shoqërisë së audituesit, duke përfshirë personelin e përkohshëm, dhe si rrjedhojë është subjekt i procedurave dhe politikave të kontrollit të cilësisë të kësaj shoqërie në përputhje me SNKC 1⁹ ose kërkesat kombëtare që janë të paktën po aq kërkuese¹⁰. Ndryshe, një ekspert i brendshëm i audituesit mund të jetë një ortak ose personel, duke përfshirë personelin e përkohshëm, të një firme të rrjetit, të cilët mund të kenë procedura dhe politika të kontrollit të cilësisë të ngjashme me ato të firmës së audituesit.

⁸ SNA 500, paragrafi 8.

⁹ SNKC 1 (ISQC 1), *Kontrolli i Cilësisë për Firmat që Kryejnë Auditime dhe Rishikime të Pasqyrave Financiare, dhe të tjera Angazhime për Dhënie dhe Sigurisë dhe Shërbimeve të Lidhura*, paragrafi 12(f).

¹⁰ SNA 220, paragrafi 2.

A12. Eksperti i jashtëm i audituesit nuk është pjesëtar i grupit të angazhimit dhe nuk është subjekt i procedurave dhe politikave të kontrollit të cilësisë në përputhje me SNKC 1¹¹. Megjithatë në disa juridiksione, ligjet ose rregulloret mund të kërkojnë që eksperti i jashtëm i audituesit të trajtohet si pjesëtar i grupit të angazhimit, dhe si rrjedhojë të jetë subjekt i kërkesave të caktuara etike, duke përfshirë ato që i përkasin pavarësisë dhe kërkesave të tjera profesionale, siç përcaktohet nga ai ligj apo rregullore.

A13. Grupet e angazhimit janë të detyruar të mbështeten mbi sistemin e kontrollit të cilësisë të shoqërisë, përveç rasteve kur informacioni i siguruar nga shoqëria ose palë të tjera sugjeron ndryshe¹². Shtrirja e kësaj mbështetje do të variojë sipas rrethanave, dhe mund të ndikojë natyrën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e procedurave të audituesit në lidhje me çështje të tilla si:

- Kompetenca dhe aftësitë, përmes programeve të rekrutimit dhe trainimit.
- Objektiviteti. Ekspertët e brëndshëm të audituesit janë subjekt i kërkesave të caktuara etike, duke përfshirë ato që i përkasin pavarësisë.
- Vlerësimi i audituesit për përshtatshmërinë e punës së ekspertit të audituesit. Për shembull, programet e trainimit të shoqërisë mund t'i sigurojnë ekspertit të brëndshëm të audituesit një kuptim më të përshtatshëm të marrëdhënies së ndërsjellë të ekspertizës së tyre me procesin e auditimit. Mbështetja në të tilla trainime dhe procese të tjera të shoqërisë, të tilla si protokollet për përcaktimin e qëllimit të punës së ekspertit të brëndshëm të audituesit, mund të ndikojë natyrën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e procedurave të audituesit për vlerësimin e përshtatshmërisë së punës së ekspertit.
- Aderimin në kërkesat rregullatore dhe ligjore, nëpërmjet proceseve vëzhguese.
- Marrëveshja me ekspertin e audituesit.

Një mbështetje e tillë nuk redukton përgjegjësinë e audituesit për përmbushjen e kërkesave të këtij SNA-je.

Kompetenca, Aftësitë dhe Objektiviteti i Ekspertit (Ref: Para. 9)

A14. Kompetenca, aftësitë dhe objektiviteti i ekspertit janë faktorë që ndikojnë shumë në faktin nëse puna e ekspertit do të jetë e përshtatshme për qëllimet e audituesit. Kompetenca lidhet me natyrën dhe nivelin e ekspertizës që zotëron eksperti. Aftësia lidhet me aftësinë e ekspertit për të ushtruar kompetencën në rrethanat e angazhimit. Faktorët që ndikojnë këtë aftësi mund të përfshijnë, për shembull, vendndodhjen geografike, dhe disponueshmërinë e kohës dhe burimeve. Objektiviteti lidhet me

¹¹ SNKC 1, paragrafi 12(f).

¹² SNA 220, paragrafi 4.

PËRDORIMI I PUNËS SË EKSPERTIT TË AUDITUESIT

efektet e mundshme që paragjykimet, konflikti i interesit, ose influenca e të tjerëve mund të kenë mbi gjykimin profesional ose të biznesit të ekspertit.

A15. Informacion në lidhje me kompetencën, aftësitë dhe objektivitetin e ekspertit mund të sigurohet nga burime të ndryshme, të tilla si:

- Eksperienca personale me punën e mëparshme të ekspertit.
- Diskutimet me ekspertin.
- Diskutimet me auditues të tjerë ose të tjerë të cilët janë familiar me punën e ekspertit.
- Njohuri mbi kualifikimet e ekspertit, anëtarësimin në një institut profesional ose bashkim i sektorit të industrisë, liçensa për të praktikuar, ose forma të tjera të njohjes së jashtme.
- Publikime ose libra të shkruar nga eksperti.
- Politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë të firmës së audituesit (shih paragrafët A11–A13).

A16. Çështje të përshtatshme që mund të merren në konsideratë në vlerësimin e kompetencës, aftësive dhe objektivitetit të ekspertit përfshijnë faktin nëse puna e ekspertit është subjekt i standardeve të performancës teknike ose kërkesave të tjera profesionale ose sektorit të industrisë, për shembull, standardet e etikës dhe kërkesa të tjera të anëtarësimit në një institut profesional ose bashkim të sektorit të industrisë, standardet e akreditimit të një instituti liçensues, ose kërkesa të detyruara nga ligjet ose rregulloret.

A17. Çështje të tjera që mund të jenë të rëndësishme përfshijnë:

- Rëndësinë e kompetencës së ekspertit në lidhje me çështjen për të cilën eksperti do të përdoret, duke përfshirë çdo fushë të specializuar brenda fushës së ekspertit. Për shembull, një aktuar i caktuar mund të specializohet në sigurimin e pasurisë dhe sigurimin e rastësishëm, por mund të zotërojë ekspertizë të kufizuar në lidhje me llogaritjet e pensioneve.
- Kompetenca e ekspertit të audituesit në lidhje me kërkesat e nevojshme të kontabilitetit dhe auditimit, për shembull, njohuri mbi supozimet dhe metodat, që përfshijnë modele (ku janë të përdorshme), që janë koherente me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
- Nëse ngjarje të papritura, ndryshime në kushtet, ose evidenca e auditimit e siguruar nga rezultatet e procedurave të auditimit tregon se mund të jetë e

nevojshme të rikonsiderohet vlerësimi fillestar i kompetencës, aftësive dhe objektivitetit të ekspertit ndërsa auditimi vazhdon.

A18. Një gamë e gjerë rrethanash mund të rrezikojë objektivitetin, për shembull, rreziku i interesit vetjak, rreziku i avokatisë, rreziku i familjaritetit, rreziku i rishikimit të punës vetjake, dhe rreziku i frikësimit. Masat mbojtëse mund të eliminojnë ose reduktojnë të tilla rreziqe, dhe mund të krijohen nga struktura të jashtme (për shembull, profesioni i ekspertit, legjislacioni ose rregulloret), ose nga mjedisi i punës së ekspertit (për shembull, politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë). Mund të ketë dhe masa mbrojtëse specifike për angazhimin e auditimit.

A19. Vlerësimi i rëndësisë së rreziqeve për objektivitetin dhe fakti nëse masat mbrojtëse janë të nevojshme mund të varen nga roli i ekspertit të audituesit dhe rëndësia e punës së ekspertit në kontekstin e auditimit. Mund të ketë rrethana në të cilat masat mbrojtëse nuk i reduktojnë rreziqet në një nivel të kënaqshëm, për shembull, nëse një ekspert i propozuar i audituesit është një individ që ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen e informacionit që po auditohet, si në rastin, kur eksperti i audituesit është ekspert i drejtimit.

A20. Kur vlerësohet objektiviteti i ekspertit të audituesit, do të ishte me rëndësi të:

- (a) Pyetet në entitet rreth ndonjë interesi të njohur ose lidhjeje që entiteti ka me ekspertin e jashtëm të audituesit që mund të ndikojë mbi objektivitetin e këtij të fundit.
- (b) Diskutohet me ekspertin për masat mbrojtëse të zbatueshme, përfshirë kërkesat profesionale që kanë të bëjnë me ekspertin; dhe të vlerësohet nëse këto masa mbrojtëse janë të përshtatshme për të reduktuar rreziqet në një nivel të kënaqshëm. Interesat dhe lidhjet që mund të jenë të përshtatshme për tu diskutuar me ekspertin përfshijnë:
 - Interesat financiarë.
 - Lidhjet personale dhe të biznesit.
 - Sigurimi i shërbimeve të tjera nga ana e ekspertit, përfshirë shërbimet e organizatës në rastin kur eksperti i jashtëm është një organizatë.

Në disa raste, mund të jetë gjithashtu e përshtatshme për audituesin të sigurojë deklarime me shkrim nga eksperti i jashtëm i audituesit në lidhje me ndonjë interes ose lidhje me entitetin për të cilat eksperti është në dijeni.

Njohja e Fushës së Ekspertizës të Ekspertit të Audituesit (Ref: Para. 10)

A21. Audituesi mund të njohë fushën e ekspertizës të ekspertit të audituesit nëpërmjet mjeteve të përshkruara në paragrafin A7, ose nëpërmjet diskutimeve me ekspertin.

A22. Aspektet e fushës së ekspertit të audituesit të rëndësishme për tu njohur nga audituesi mund të përfshijnë:

- Nëse fusha e ekspertit ka aspekte specifike brenda saj që janë të rëndësishme për auditimin (shih paragrafin A17).
- Nëse zbatohet ndonjë standard profesional ose standarte të tjerë dhe rregullore ose kërkesa ligjore.
- Çfarë supozimesh dhe metodash, përfshirë modelet (ku janë të aplikueshme), përdoren nga eksperti i audituesit, dhe nëse ato janë të pranuar gjërësisht brenda fushës së ekspertit dhe janë të përshtatshme për qëllime të raportimit financiar.
- Natyra e të dhënave të brendshme dhe të jashtme ose informacionit që përdor eksperti.

Marrëveshja me Ekspertin (Ref: Para. 11)

A23. Natyra, objekti dhe objektivat e punës së ekspertit mund të variojnë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të rrethanave, ashtu sikurse mund të variojnë dhe rolet dhe përgjegjësitë respektive të audituesit dhe ekspertit të audituesit, si dhe natyra, kohëzgjatja dhe shtrirja e komunikimit ndërmjet audituesit dhe ekspertit të audituesit. Si rrjedhojë kërkohet që për këto çështje të bihet dakort ndërmjet audituesit dhe ekspertit të audituesit pavarësisht nëse eksperti është një ekspert i jashtëm apo i brendshëm i audituesit.

A24. Çështjet e cituara në paragrafin 8 mund të ndikojnë në nivelin e detajeve dhe formalizimin e marrëveshjes ndërmjet audituesit dhe ekspertit, duke përfshirë nëse është e përshtatshme që marrëveshja të jetë me shkrim. Për shembull, faktorët e mëposhtëm mund të sugjerojnë nevojën për një marrëveshje më të detajuar se ç'mund të ishte në një rast të kundërt, ose për marrëveshjen që të jetë me shkrim:

- Eksperti i audituesit do të ketë të drejta hyrjeje në informacionin e ndjeshëm dhe konfidencial të entitetit.
- Rolet dhe përgjegjësitë respektive të audituesit dhe ekspertit të audituesit janë të ndryshme nga ato që pritet të jenë zakonisht.
- Zbatohen kërkesat ligjore dhe rregullatore të shumë juridiksioneve.
- Çështja me të cilën lidhet puna e ekspertit është shumë komplekse.
- Audituesi nuk e ka përdorur më parë punën e bërë nga eksperti.

- Sa më e madhe shtrirja e punës së ekspertit të audituesit, dhe rëndësia e saj në kontekstin e auditimit.

A25. Marrëveshja ndërmjet audituesit dhe ekspertit të jashtëm të audituesit është shpesh në formën e një letre angazhimi. Shtojca liston çështje të cilat audituesi mund t'i marrë në konsideratë për t'i përfshirë në një letër të tillë angazhimi, ose në çdo formë tjetër marrëveshjeje me ekspertin e jashtëm të audituesit.

A26. Kur nuk ka një marrëveshje të shkruar ndërmjet audituesit dhe ekspertit, evidenca e marrëveshjes mund të përfshihet, për shembull në:

- Memorandumi i planifikimit, ose në fletët e caktuara të punës të tilla si programi i auditimit.
- Politikat dhe procedurat e firmës së audituesit. Në rastin e një eksperti të brendshëm të audituesit, politikat dhe procedurat e vendosura, subjekt i të cilave është dhe eksperti mund të përfshijnë politika dhe procedura të veçanta në lidhje me punën e atij eksperti. Shtrirja e dokumentacionit në fletët e punës së audituesit varet nga natyra e politikave dhe procedurave të tilla. Për shembull, nuk do të nevojitet dokumentacion në fletët e punës së audituesit nëse firma e audituesit ka protokolle të detajuara që mbulojnë rrethanat në të cilat do të përdoret puna e ekspertit.

Natyra, Objekti dhe Objektivat e Punës (Ref: Para. 11(a))

A27. Shpesh do të ishte e rëndësishme që të përfshihen diskutime lidhur me ndonjë standard të performancës teknike ose kërkesa të tjera profesionale apo të sektorit të industrisë që eksperti duhet të ndjekë, kur bihet dakort për natyrën, objektin dhe objektivat e punës së ekspertit të audituesit.

Rolet dhe Përgjegjësitë Respektive (Ref: Para.11(b))

A28. Marrëveshja mbi rolet dhe përgjegjësitë respektive të audituesit dhe ekspertit të audituesit mund të përfshijë:

- Nëse audituesi ose eksperti i audituesit do të zhvillojë testime të detajuara të të dhënave bazë.
- Pranimi i audituesit për të diskutuar me entitetin dhe të tjerët, gjetjet dhe përfundimet e ekspertit të audituesit, dhe të përfshijë nëse është e nevojshme, në raportin e auditimit detajet e gjetjeve dhe përfundimeve të ekspertit si bazë për një opinion të modifikuar. (shih paragrafin A42).
- Ndonjë marrëveshje për të informuar ekspertin e audituesit për përfundimet e audituesit në lidhje me punën e ekspertit.

Fletët e Punës

A29. Marrëveshja mbi rolet dhe përgjegjësitë respektive të audituesit dhe ekspertit të audituesit mund të përfshijë gjithashtu marrëveshje për hyrjen në, dhe ruajtjen e fletëve të punës së njëri tjetrit. Kur eksperti i audituesit është pjesëtar i grupit të angazhimit, fletët e punës së ekspertit përbëjnë pjesë të dokumentacionit të auditimit. Përveç rasteve kur është rënë dakort ndryshe, fletët e punës së ekspertit të jashtëm janë në pronësi të tij dhe nuk janë pjesë e dokumentacionit të auditimit.

Komunikimi (Ref: Para. 11(c))

A30. Komunikimi efektiv nga të dyja palët ndihmon në integrimin e përshtatshëm të natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së procedurave të ekspertit të audituesit me punën tjetër të auditimit, dhe në modifikimet e përshtatshme të objektivave të ekspertit të audituesit përgjatë auditimit. Për shembull, kur puna e ekspertit të audituesit lidhet me përfundimet e audituesit rreth një rreziku të rëndësishëm, mund të jenë të përshtatshme si raportimet jo formale përgjatë progresit të punës ashtu dhe raportimet formale të shkruara në përfundim të punës së ekspertit. Identifikimi i ortakëve të caktuar ose punonjësve të cilët do të bashkëpunojnë me ekspertin, dhe procedurat për komunikim ndërmjet ekspertit dhe entitetit, ndihmojnë komunikimin efektiv dhe në kohë, veçanërisht në angazhimet e mëdha.

Konfidencialiteti (Ref: Para. 11(d))

A31. Është e nevojshme që për sigurimin e konfidencialitetit kërkesa të caktuara etike që zbatohen nga audituesi të zbatohen gjithashtu edhe nga eksperti i audituesit. Kërkesa shtesë mund të vendosen edhe nga ligji apo rregulloret. Entiteti mund të kërkojë gjithashtu që për provizione specifike të konfidencialitetit të bihet dakort me ekspertin e jashtëm të audituesit.

Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Punës së Ekspertit (Ref: Para. 12)

A32. Vlerësimi i audituesit mbi kompetencën, aftësitë dhe objektivitetin e ekspertit, familiariteti i audituesit me fushën e ekspertizës së ekspertit, dhe natyra e punës së kryer nga eksperti ndikojnë në natyrën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e procedurave të auditimit për të vlerësuar përshtatshmërinë e punës së ekspertit për qëllime të audituesit.

Gjetjet dhe Përfundimet e Ekspertit të Audituesit (Ref: Para. 12(a))

A33. Procedurat specifike për vlerësimin e përshtatshmërisë së punës së ekspertit për qëllimet e audituesit mund të përfshijnë:

- Intervista të bëra ekspertit të audituesit.
- Rishikimin e fletëve të punës dhe raporteve të ekspertit.

- Procedurat konfirmuese, të tilla si:
 - Vëzhgimi i punës së ekspertit të audituesit;
 - Egzaminimi i të dhënave të publikuara, të tilla si raportet statistikore nga burime të besueshme dhe me reputacion;
 - Konfirmimi i çështjeve të rëndësishme me palë të treta;
 - Kryerja e procedurave analitike të detajuara; dhe
 - Rikryerja e llogaritjeve.
- Diskutimi me një ekspert tjetër që ka ekspertizën e nevojshme kur, për shembull, gjetjet ose përfundimet e ekspertit të audituesit nuk janë në koherencë me evidencën tjetër të auditimit.
- Diskutimi me drejtimin i raportit të ekspertit të audituesit.

A34. Faktorë të rëndësishëm kur vlerësohet rëndësia dhe arsyeshmëria e gjetjeve dhe përfundimeve të ekspertit, në formë raporti apo në një formë tjetër, mund të përfshijnë, nëse ato janë:

- Prezantuar në një mënyrë e cila është në koherencë me çdo standard të profesionit apo sektorit të industrisë të ekspertit;
- Shprehur qartësisht, duke përfshirë referimin e objektivave të rëna dakort me audituesin, qëllimin e punës së kryer dhe standartet e zbatuara;
- Bazuar në një periudhë të përshtatshme dhe marrin parasysh ngjarjet e mëvonshme, aty ku është e përshtatshme;
- Subjekt i ndonjë rezerve, kufizimi ose ndalimi në përdorim, dhe në rast të tillë, nëse ka ndikime për audituesin; dhe
- Bazuar në marrjen parasysh të gabimeve ose devijimeve të hasura nga eksperti i audituesit.

Supozimet, Metodat dhe të Dhënat Bazë

Supozimet dhe Metodat (Ref: Para. 12(b))

A35. Kur puna e ekspertit të audituesit ka të bëjë me vlerësimin e supozimeve dhe metodave themelore, duke përfshirë ku është e nevojshme modelet, e përdorura nga drejtimi në zhvillimin e një çmuarje kontabile, procedurat e audituesit ka shumë

mundësi të drejtohen si fillim në vlerësimin nëse eksperti ka rishikuar në mënyrë të përshtatshme këto supozime dhe metoda. Kur puna e ekspertit të audituesit është që të zhvillojë një pikë ose një gamë vlerësimi të audituesit për krahasim me pikën e vlerësimit të drejtimit për çmuarjen, procedurat e audituesit do të drejtohen fillimisht në vlerësimin e supozimeve dhe metodave, duke përfshirë ku është e nevojshme, modelet e përdorura nga eksperti i audituesit.

A36. SNA 540¹³ diskuton supozimet dhe metodat e përdorura nga drejtimi në bërjen e çmuarjeve kontabël, duke përfshirë përdorimin në disa raste të modeleve shumë të specializuara të ndërtuara nga entiteti. Edhe pse ky diskutim është shkruar në kontekstin e audituesit që siguron evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me supozimet dhe metodat e drejtimit, ai mund të ndihmojë gjithashtu audituesin kur vlerëson supozimet dhe metodat e ekspertit të audituesit.

A37. Kur puna e ekspertit të audituesit përfshin përdorimin e supozimeve dhe metodave të rëndësishme, faktorët e nevojshëm në vlerësimin e audituesit të këtyre supozimeve dhe metodave përfshijnë nëse ato janë:

- Të pranuar gjërësisht brenda fushës së ekspertit;
- Në pajtim me kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar;
- Në varësi të përdorimit të modeleve të specializuara; dhe
- Në pajtim me ato të drejtimit, dhe në rast se jo, arsyen dhe efektet e diferencave.

Të dhënat Burimore të Përdorura nga Eksperti i Audituesit (Ref: Para. 12(c))

A38. Kur puna e ekspertit të audituesit përfshin përdorimin e të dhënave burimore që janë të rëndësishme për punën e ekspertit, procedura të tilla si ato në vijim mund të përdoren për të testuar të dhënat:

- Verifikimi i origjinës së të dhënave, duke përfshirë njohjen, dhe ku është e nevojshme testimin e kontrolleve të brëndshme mbi të dhënat dhe, ku është e përshtatshme, trasmetimin e tyre tek eksperti.
- Rishikimi i të dhënave për plotësi dhe përputhshmëri të brëndshme.

A39. Në shumë raste, audituesi mund të testojë të dhënat burimore. Megjithatë, në raste të tjera, kur natyra e të dhënave burimore të përdorura nga eksperti i audituesit është shumë teknike në lidhje me fushën e ekspertit, vetë eksperti mund të testojë të dhënat burimore. Nëse eksperti i audituesit i ka testuar të dhënat burimore, intervistat e bëra ekspertit nga audituesi, ose mbikqyrja apo rishikimi i testeve të

¹³ SNA 540, *Auditimi i Çmuarjeve Kontabël, përfshirë Çmuarjet kontabël me Vlerën e Drejtë dhe Informacionet Shpjeguese Përkatëse* paragrafët 8, 13 dhe 15

ekspertit mund të jenë një mënyrë e përshtatshme për audituesin për të vlerësuar përshtatshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e të dhënave.

Puna e Papërshtatshme (Ref: Para. 13)

A40. Nëse audituesi arrin në përfundimin se puna e ekspertit nuk është e përshtatshme për qëllimet e audituesit dhe audituesi nuk mund ta zgjidhë çështjen nëpërmjet procedurave shtesë të auditimit të kërkuara nga paragrafi 13, të cilat mund të përfshijnë punë të mëtejshme të kryer si nga audituesi ashtu dhe nga eksperti, ose përfshijnë marrjen në punë ose angazhimin e një eksperti tjetër, mund të jetë e nevojshme të shprehet një opinion i modifikuar në raportin e audituesit në përputhje me SNA 705 (i rishikuar) pasi audituesi nuk ka siguruar evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme¹⁴.

Referimi i Ekspertit të Audituesit në Raportin e Audituesit (Ref: Para. 14–15)

A41. Në disa raste, ligji apo rregulloret mund të kërkojnë referim të punës së ekspertit, për shembull, për qëllime të transparencës në sektorin publik.

A42. Në disa rrethana mund të jetë e përshtatshme që të referohet eksperti i audituesit në raportin e audituesit që përmban një opinion të modifikuar, për të sqaruar natyrën e modifikimit. Në këto rrethana, audituesi duhet të marrë miratimin e ekspertit të audituesit përpara se të bëjë një referim të tillë.

¹⁴ SNA 705 (i rishikuar), “Modifikimet e Opinioneve në Raportin e Audituesit të Pavarur,” paragrafi 6(b).

Shtojcë

(Ref: Para. A25)

Konsiderata në lidhje me Marrëveshjen ndërmjet Audituesit dhe Ekspertit të Jashtëm të Audituesit

Ky aneks liston çështje që audituesi mund t'i konsiderojë për t'i përfshirë në çdo marrëveshje me ekspertin e jashtëm të audituesit. Lista e mëposhtme është vetëm ilustruese dhe nuk është e plotë; ka si synim që të shërbejë vetëm si udhërrëfyes për tu përdorur së bashku me konsideratat e nënvizuara në këtë SNA. Fakti nëse duhen përfshirë çështje të caktuara në marrëveshje varet nga rrethanat e angazhimit. Lista mund të ndihmojë gjithashtu në konsiderimin e çështjeve për tu përfshirë në një marrëveshje me një ekspert të brëndshëm të audituesit.

Natyra, Objekti dhe Objektivat e Punës së Ekspertit të Jashtëm të Audituesit

- Natyra dhe objekti i procedurave që do të kryejë eksperti i jashtëm i audituesit.
- Objektivat e ekspertit të jashtëm të audituesit në kontekstin e materialitetit dhe kujdesit ndaj rrezikut që ka të bëjë me çështjen me të cilën është e lidhur puna e ekspertit të jashtëm të audituesit, dhe, ku është e përshtatshme, kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar.
- Ndonjë standard performance teknike ose kërkesa të tjera profesionale apo te sektorit të industrisë që eksperti i jashtëm i audituesit duhet të zbatojë.
- Supozimet dhe metodat, përfshirë aty ku është e zbatueshme modelet, që eksperti i jashtëm i audituesit do të përdorë, dhe autoriteti i tyre.
- Data e hyrjes në fuqi të, ose kur është e zbatueshme periudha e testimit të, çështjes që ka të bëjë me punën e ekspertit të jashtëm të audituesit, dhe kërkesat lidhur me ngjarjet e mëvonshme.

Rolet dhe Përgjegjësitë Respektive të Audituesit dhe Ekspertit të Jashtëm të Audituesit

- Standardet e zbatueshme të auditimit dhe kontabilitetit, dhe kërkesat e zbatueshme rregullatore ose ligjore.
- Miratimin e ekspertit të audituesit të jashtëm për përdorimin e raportit të tij, përfshirë referimin ndaj raportit, ose dhënien e informacionit lidhur me të, palëve të tjera, për shembull referim ndaj raportit si bazë për një opinion të modifikuar në raportin e audituesit, nëse është e nevojshme, ose paraqitja e raportit tek drejtimi apo komiteti i auditimit.

- Natyra dhe shtrirja e rishikimit të audituesit ndaj punës së ekspertit të jashtëm të audituesit.
- Faktin nëse audituesi ose eksperti i jashtëm i audituesit do të testojë të dhënat burimore.
- Niveli i hyrjes së ekspertit të jashtëm të audituesit në regjistrat, dosjet, personelin dhe ekspertët e angazhuar të entitetit.
- Procedurat për komunikimin ndërmjet ekspertit të jashtëm të audituesit dhe entitetit.
- Niveli i hyrjes në fletët e punës respektive të audituesit dhe ekspertit të jashtëm të audituesit.
- Pronësia dhe kontrolli i fletëve të punës gjatë dhe pas angazhimit, përfshirë kërkesat për përdorimin e dosjes.
- Përgjegjësia e ekspertit të jashtëm të audituesit për të kryer punën me aftësitë dhe kujdesin e duhur.
- Kompetenca dhe aftësia e ekspertit të jashtëm të audituesit për të kryer punën.
- Pritshmëria që eksperti i jashtëm i audituesit do të përdorë të gjitha njohuritë që ka dhe që kanë të bëjnë me auditimin, ose, në rast të kundërt detyrimi për të informuar audituesin.
- Ndonjë kufizim për përfshirjen e ekspertit të jashtëm të audituesit në raportin e audituesit.
- Ndonjë marrëveshje për të informuar ekspertin e jashtëm të audituesit për konkluzionet e audituesit lidhur me punën e ekspertit.

Komunikimet dhe Raportimi

- Mënyrat dhe frekuenca e komunikimeve, përfshirë:
 - Mënyrën se si gjetjet ose konkluzionet e ekspertit të jashtëm të audituesit do të raportohen (për shembull, raport me shkrim, raport verbal, informim i vazhdueshëm i grupit të angazhimit).
 - Identifikimi i personave të caktuar brenda grupit të angazhimit të cilët do të komunikojnë me ekspertin e jashtëm të audituesit.
- Kohën brenda të cilës eksperti i jashtëm i audituesit do të përfundojë punën dhe do të raportojë gjetjet dhe konkluzionet tek audituesi.

PËRDORIMI I PUNËS SË EKSPERTIT TË AUDITUESIT

- Përgjegjësinë e ekspertit të jashtëm të audituesit për të komunikuar në kohë ndonjë vonesë të mundshme në lidhje me përfundimin e punës, dhe ndonjë kufizim të mundshëm në gjetjet dhe konkluzionet e ekspertit.
- Përgjegjësinë e ekspertit të jashtëm të audituesit për të komunikuar në kohë rastet në të cilat entiteti kufizon nivelin e hyrjes së ekspertit në regjistrat, dosjet, personelin dhe ekspertët e angazhuar të entitetit.
- Përgjegjësinë e ekspertit të jashtëm të audituesit për t'i komunikuar audituesit të gjithë informacionin që eksperti beson që mund të jetë i përshtatshëm për auditimin, përfshirë ndonjë ndryshim në rrethanat e komunikuar më parë.
- Përgjegjësinë e ekspertit të jashtëm të audituesit për të komunikuar rrethanat që mund të krijojnë kërcënime ndaj objektivitetit të ekspertit, dhe ndonjë masë mbrojtëse të përshtatshme për t'i pakësuar këto kërcënime në një nivel të pranueshëm.

Konfidencialiteti

- Nevojën e ekspertit të audituesit për të vëzhguar kërkesat e konfidencialitetit, përfshirë:
 - Dispozitat e konfidencialitetit që kanë të bëjnë me kërkesat etike të nevojshme që zbatohen nga audituesi.
 - Kërkesa shtesë që duhen zbatuar sipas ligjit ose rregulloreve, nëse ka.
 - Dispozita konfidencialiteti specifike të kërkuara nga entiteti, nëse ka.